

Përmbledhje mbi të rejat më të fundit

Miratohet ligji nr.55/2020
“Për shërbimet e pagesave”

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr.55/2020 “Për shërbimet e pagesave.” Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kuadrit ligjor për shërbimet e pagesave në Republikën e Shqipërisë.

Ky ligj ka si objekt përcaktimin e kushteve dhe rregullave për:

- a) krijimin, licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave;
- b) transparencën e kushteve dhe kërkesat për informim për shërbimet e pagesave;
- c) të drejtat e detyrimet përkatëse të përdoruesve dhe të ofruesve të shërbimeve të pagesave lidhur me ofrimin e shërbimeve të pagesave si një veprimtari e vazhdueshme ose aktivitet tregtar.

Për të lexuar ligjin e plotë, klikoni në linkun e mëposhtëm:

<https://qbz.gov.al/eli/ligi/2020/04/30/55/6ab31548-5dba-489a-815a-9a917af0eca4>

Miratohet ligji nr.62/2020
“Për tregjet e kapitalit”

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr.62/2020 “Për tregjet e kapitalit”. Objekti i këtij ligji është rregullimi i tregjeve të kapitalit, mënyrës dhe kushteve për ofrimin, blerjen dhe shitjen e instrumenteve financiare në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcaktimi i procedurave për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve të instrumenteve financiare.

Ky ligj përcakton:

- a) kushtet për themelimin, licencimin, ushtrimin e aktivitetit, mbikëqyrjen dhe prishjen e shoqërive, që ushtrojnë veprimtari të rregulluara sipas këtij ligji;
- b) kushtet për ofrimin e veprimtarive të rregulluara dhe të shërbimeve ndihmëse përkatëse;
- c) kushtet për tregtimin e instrumenteve financiare në një treg të rregulluar ose jashtë një tregu të rregulluar;
- d) kushtet për ofrimin e titujve publikut dhe pranimin e titujve në një treg të rregulluar;
- e) detyrimet për dhënien e informacionit nga shoqëritë që ushtrojnë veprimtari të rregulluara sipas këtij ligji;

- f) masat e parandalimit të abuzimeve me tregun dhe tregtimit të titujve bazuar në informacion të privilegjuar;
- g) kompetencat dhe veprimtarinë e Autoritetit në zbatim të këtij ligji.

Ky ligj zbatohet ndaj të gjitha subjekteve që ushtrojnë veprimtari të rregulluara në territorin e Republikës së Shqipërisë ose nga Republika e Shqipërisë për klientët që ndodhen jashtë saj.

Për të lexuar ligjin e plotë, klikoni në linkun e mëposhtëm:

<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/05/14/62/7b0a2301-d5b2-448c-ad66-b8f75b8fe295>

Miratohet ligji nr.66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr.66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”. Objekti i këtij ligji është rregullimi i emetimit të tokenëve digjitalë dhe/ose të monedhave virtuale, i licencimit, monitorimit dhe mbikëqyrjes së subjekteve që ushtrojnë aktivitetin eshpërndarjes, tregtimit e ruajtjes së tokenëve digjitalë dhe/ose monedhave virtuale, i agjentit të tokenëve digjitalë, ofruesit të shërbimeve inovative dhe sipërmarrjes së automatizuar të investimeve kolektive.

Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimtaritë e rregulluara dhe subjektet, që ushtrojnë veprimtarisipas këtij ligji, në ose nga territori i Republikës së Shqipërisë.

Për të lexuar ligjin e plotë, klikoni në linkun e mëposhtëm:

<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/05/21/66/ac74c417-ed9d-4f66-8083-f3cd1b6e79f2>

Miratohet ligji nr.93/2020 “Për ratifikimin e Konventës Shumëpalëshe (MLI) për zbatimin e masave që lidhen me marrëveshjet tatimore për parandalimin e erozionit të bazës dhe transferimit të fitimeve (BEPS)”

Hapja e bareve, restoranteve dhe pishinave në ambientet e mbyllura

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr.93/2020 “Për ratifikimin e Konventës Shumëpalëshe (MLI) për zbatimin e masave që lidhen me marrëveshjet tatimore për parandalimin e erozionit të bazës dhe transferimit të fitimeve (BEPS)”. Referuar këtij ligji ratifikohet konventa shumëpalëshe (MLI) për zbatimin e masave që lidhen me marrëveshjet tatimore për parandalimin e erozionit të bazës dhe transferimit të fitimeve (BEPS).

Ky ligj ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për të lexuar ligjin e plotë dhe Konventën Shumëpalëshe, klikoni në linkun e mëposhtëm:

<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/07/16/93/3bbda8a2-b07f-4a0b-948b-af1c813409ee>

Komiteti Teknik i Ekspertëve ka miratuar protokollet e sigurisë për rihapjen nga data 1 tetor e bareve, restoranteve dhe pishinave në ambientet e mbyllura, ku distancimi fizik, higjiena dhe mbajtja e maskës nga stafet që shërbejnë është e detyrueshme në çdo subjekt. Këto subjekte do të duhet të zbatojnë rregullat anti-COVID për t’u lejuar të ushtrojnë aktivitetin edhe në ambientet e brendshme. Çdo shkelje do të konsiderohet cënim i shëndetit të qytetarëve dhe si e tillë do të ndëshkohet sipas rregullave në fuqi. Task-Forca e inspektimit të protokolleve anticovid, policia e shtetit dhe policia bashkiake do të inspektojnë zbatimin e protokolleve duke ndërmarrë masat sipas legjislationit në fuqi, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve.

Ndërkohë që vijojnë të mos lejohen aktivitetet e lounge-bar dhe klubeve të natës, diskove etj sipas legjislationit në fuqi.

Për të lexuar protokollet për baret dhe restorantet, klikoni në linkun e mëposhtëm:

<https://new.shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/09/543-14MSHMSUdhezues-i-masave-higjeno-sanitare-COVID-19-ne-bare-ose-restorante-ne-mjedise-te-mbyllura.pdf>